



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 24.05.2023

Nr: 136

Ora: 15:10

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 74, DATË 22.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA Z. LEFTER MALIQI

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 24.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Z. Lefter Maliqi, kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Kuçovë, përfaqësuar nga avokati, z. Arben Llangozi

PALË E INTERESUAR: "Partia Socialiste e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Eridian Salianji

OBJEKT:

- Ndryshimi i Vendimit Nr. 101 datë 16.06.2023 të ZAZ-së Nr. 64 Bashkia Kuçovë, Qarku Berat, "Për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për Zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë".
- Rinumërim dhe rivlerësim i votave për ZAZ-në Nr. 64, të gjitha QV-të duke përfshirë në të rezultatit e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë.
- Pavlefshmëria e vendimit nr. 101 datë 16.05.2023, "Për Miratimin



e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për Zgjedhjen e Kryetarit të bashkisë Kuçovë”.

4. Konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit të KQZ ku është emëruar sekretari i KZAZ, Nr.64 Kuçovë, shtetasi Romeo Arizi.

5. Pavlefshmërinë e vendimit të KZAZ, Nr.64 Kuçovë, Qarku Berat, për shtyrjen e numërimit të votës, nga ora 11:00 deri në 12:30.

6. Pavlefshmërinë e pjeshme të fletës së votimit Kandidatët për Kryetar Bashki për Bashkinë Kuçovë, në pikën ku është shënuar kandidati për Bashkinë Kuçovë Qarku Berat Kreshnik Hajdari.

7. Pavlefshmërinë e veprimit juridik, formularin e dekriminalizimit, në emër të Kreshnik Hajdarit dorëzuar pranë K.Q.Z referuar ligjit, nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

BAZË LIGJORE:

Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Z. Lifter Maliqi, kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Kuçovë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 74 regj., datë 22.05.2023.

Në mbledhjen e datës 24.05.2023, pas relatimit të z. Ilirjan Rusmali u konstatua se kërkesa ankimore nr. 74 i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Gjatë seancës paraprake, subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Eridian Salianji depozitoi kërkesën nr.5425 prot., datë 24.05.2023, për të marrë pjesë si palë e interesuar në seancën e shqyrtimit të kërkesës ankimore. Kjo kërkesë u pranua nga KAS.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 74, datë 22.05.2023, të paraqitur nga z. Lefter Maliqi, me objekt ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.05.2023 të ZAZ nr. 64, bashkia Kuçovë.
2. Rrëzimin për mungesë kompetence për kërkesat e tjera të paraqitur në kërkesë ankimore.
3. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 26.05.2023, ora 11:30.
4. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar